

P Z A P  
I P Ž P



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 440/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendlodur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes se posterave në afersi të Qendrave të Votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**REUZOHET** si e pabazuara ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik AKR, me te cilën pretendohet se posterat e subjektit politik AAK, kane qenë të vendosur në hyrjet te shkollave “Ylli Morina” dhe Mazllum Pushka” në Gjakovë, që është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika (a) dhe (b) te LZP-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

**Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:**

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përbushin standarde*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, nen 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rrëth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkaku se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë nga subjekti politik AAK. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 440/2010 më datën 13.12.2010.

